



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

---

Numri i lëndës: 2019:269022

Datë: 22.04.2021

Numri i dokumentit: 01721284

**A.nr.102/2018**

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti për Çështje Administrative**, me gjyqtaren Anita Nikçi-Morina dhe me zyrtaren ligjore Alabana Shabani në konfliktin administrativ të paditësit K. B. të cilin sipas autorizimit e përfaqëson avokatja H. A. kundër të paditurës Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me seli në Prishtinë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson F. G.– bashkëpuntor profesional, për shkak të anulimit të vendimit në shqyrtimin kryesor publik, të mbajtura në prani me datë 25.03.2021 merr këtë:

**AKTGJYKIM**

**I. APROVOHET** si e bazuar kërkesëpadia e K. B. me banim në P.

**II. ANULOHET** vendimi i të paditurës- Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës, me nr. ..., dt. ..., dhe çështja kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje tek e paditura.

**III.** Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës.

**Arsyetim**

Shqyrtimi kryesor në këtë çështje juridike, është mbajtur në prezencë të dy palëve ndërgjyqësve- përfaqësuesve të tyre.

Përfaqësuesja e paditësit në seancën e shqyrtimit kryesor ka kërkuar anulimin e vendimit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës ..., dt. ..., duke pretenduar se vendimi është marrë në kundërshtim me dispozitat ligjore. Në veçanti përfaqësuesja e paditësit pretendon se organi i paditur nuk ka zbatuar në mënyrë të drejtë dhe konform dispozitave ligjore llogaritjen e afateve për parashtrim të ankesës duke bërë që të cenohet interesi juridik i paditësit në këtë çështje administrative.

Përfaqësuesi i të paditurës në seancën e shqyrtimit kryesor deklaroi se mbetet në tërësi pranë përgjigjes në padi si dhe vendimit të këshillit ..., pasi që i njëjti është i drejtë dhe i bazuar në dispozitat ligjore, gjithashtu kërkon nga gjykata që ta vërtetojë si të tillë, ndërsa padinë e paditësit ta refuzojë. Sa i përket pretendimeve që potencojë avokatja gjatë seancës gjyqësore përfaqësuesi thekson se ankuesi z. B. në ankesën e parashtruar në KPMSHCK të dt.06.11.2017 në përmbajtje të ankesës e ka deklaruar me vullnetin e tij se që nga data e kthimit 17.07.2017 në lidhje me mos ekzekutimin e mëditjeve thotë “ se për plot tre muaj kam tentuar të bisedoj me personin përgjegjës dhe i kam kërkuar vazhdimisht të zbatoj ligjin “. Andaj nga kjo rrjedh se ankuesi i ka humbur afatet kohore siç janë të përcaktuara në rregulloren nr.5/2011 për procedurat e zgjidhjes së kontesteve dhe ankesave.

Me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, Gjykata në seancën e datës 25.03.2021 ka bërë administrimin e provave relevante dhe atë: Lista ku i njëjti është nominuar në trajnimin ndërkombëtar të mbrojtjes në listën e studenteve internacional, listimi i programit gjatë javës, kopja e pasaportës- viza e disa shteteve, komunikimi në mënyrë elektronike dt..., komunikimi në mënyrë elektronike dt..., ankesë dt..., vendim ..., dt..., kërkesa për udhëtim zyrtar me nr..., dt..., parashtrësia e dt..., urdhër obligimi për pagesë dt..., komunikimi në mënyrë elektronike dt..., komunikimi në mënyrë elektronike dt..., komunikimi në mënyrë elektronike dt..., përgjigja në kërkesë dt..., akt emërimi me nr. Protokollin ..., dt..., përkrahimi i detyrave të punës dt..., plani vjetor i trajnimit i nëpunësve civil për periudhën janar-dhjetor 2017, komunikimi në mënyrë elektronike dt..., formulari i regjistrimit të ankesës dt..., të dhënat bankare shkresë- mëditja në cilën i është paguar mëditja në udhëtimin zyrtar ..., deri me dt. ...

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit të goditur me padi në përputhje me nenin 44 të Ligjit për Konfliktet Administrative dhe provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, ku ka gjetur se kërkesëpadija e paditësit është e bazuar.

Paditësit, i punësuar në Sekretariatit e Këshillit të Sigurisë së Kosovës, në pozitën „Analist“, në Departamentin e Analizave dhe Politikave të Sigurisë me datë ..., i ishte aprovuar kërkesa për realizimin e udhëtimit për vijimin e trajnimit të aftësisë profesionale në fushën e sigurisë në Angli prej datës ..., deri me datë ....

Pas kthimit nga udhëtimi zyrtar me datën ..., paditësi ka bërë kërkesë për realizimin mëditjeve duke kërkuar ekzekutimin e mëditjeve në shumën prej 3.292.80 euro konform nenit 13 të Udhëzimit Administrativ 2004/07.

Për shkak të zvarritjes së bartjes së mjeteve respektivisht të pagesës së mëditjeve lidhur me udhëtimin zyrtar, paditësi i drejtohet me email autoritetit kompetent në institucion më dt. 02.10.2017 respektivisht z. Sh. Sh. i cili në përgjigjen e dhënë zyrtarisht dhe përmes emailit është deklaruar se ekzekutimi i mëditjeve nuk mund të bëhet pasi

udhëtimi zyrtar është bërë në kundërshtim me Udhëzimin Administrativ 2004/07 për udhëtime zyrtare.

Pas pranimit të emailit zyrtar, me datë ..., paditësi i drejtohet me ankesë Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave dhe Kryesuesi i Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave me datë 10.10.2017 i është përgjigjur ankuesit tani paditësit se Komisioni nuk mund të mblidhet pasi nuk është i kompletuar dhe se ankesa nuk mund të shqyrtohet deri sa të nxirret një vendim nga Sekretari i Këshillit të Sigurisë së Kosovës për funksionalizimin e Komisionit.

Paditësi, i pa kënaqur me vendimin e Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave, më dt. 16.11.2017 parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës, i cili pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se ankesa e paditësit është e palejuar pasi ankuesit/tani paditësit momenti për ankim në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave ka filluar të rrjedh brenda 30 ditëve nga data 01.09.2017, datë kjo kur paditësi ka kuptuar që në xhirollogarinë e tij nuk i është bërë pagesa e mëditjeve për udhëzim zyrtar.

Gjykata konstaton se vendimi i KPMSHC-së me të cilin është konstatuar se ankuesi, jashtë afatit ligjor ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave, është juridikisht i padrejtë.

Gjykata ka analizuar me kujdes provat e administruara për vërtetimin e gjendjes faktike dhe ka konstatuar se në bazë shkresave të lëndës paditësi ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave vetëm pasi i është refuzuar rimbursimi i mjeteve të mëditjes nga zyrtari kompetent më datë 02.10.2017. Organi i paditur i është referuar datës 01.09.2017 si datë kur paditësi ka kuptuar se në xhirollogarinë e tij nuk kanë dalur mjetet si moment kur ka filluar të rrjedh afati për paraqitjen e ankesës në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave. Por Gjykata gjen se një konstatim i tillë nuk mbështetet në përmbajtjen e nenit 8 para 2 të Rregullores Nr. 05/2011 lidhur me procedurat e zgjidhjes së kontesteve dhe ankesave, që përcakton se “ankesa duhet të parashtrohet brenda afatit prej (30) ditësh kur nëpunësi civil konsideron se i janë shkelur të drejtat e tij nga marrëdhënia e punës”. Gjykata konsideron që momenti i pranimit të informacionit për mohimin e së drejtës për rimbursim më dt. 02.10.2017 është momenti kur paditësi ka konstatuar se i janë shkelur të drejtat e tij dhe jo momenti kur paditësi ka kuptuar se nuk i janë bartur mjetet e mëditjes për realizimin e udhëtimit zyrtar.

Ky konstatim mbështetet në nenin 127 të Ligjit për 05/l -031 për procedurën e përgjithshme administrative, sipas të cilit “1. ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ. 2. Pala e tretë që nuk ka marrë pjesë në procedurën administrative dhe nuk i është njoftuar akti, mund të parashtrojë ankesën brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur ka marrë apo duhej të kishte marrë dijëni për aktin, por jo më vonë se gjashtë (6) muaj nga nxjerrja e

aktit. 3. Nëse akti administrativ është lëshuar pa informacion, apo me informacion të pamjaftueshëm në lidhje me mjetet juridike administrative (këshillën juridike), afati i parashikuar nga paragrafi 1 i këtij neni, është tre (3) muaj. 4. Ankesa kundrejt heshtjes administrative mund të parashtrohet jo më herët se shtatë (7) ditë dhe jo më vonë se dy (2) muaj pas skadimit të afatit për njoftimin e aktit administrativ”.

Paditësi ka argumentuar se ka qenë pikërisht data 02.10.2017 referuar emailit të zyrtarit kompetent në kuadër të Këshillit të Sigurisë së Kosovës përmes të cilit i është komunikuar se rimbursimi i mjeteve të kërkuara për mëditje nuk mund të ekzekutohet me arsyetimin e shkurtër se udhëtimi zyrtar nuk ka qenë në pajtim me legjislacionin në fuqi. Gjykata përveç se gjen se nuk janë dhënë arsye adekuate juridike lidhur me mosnjohjen e së drejtës për rimbursim në emailin zyrtar, ky përbën edhe momentin kur pala është njoftuar për aktin administrativ.

Prandaj në këtë drejtim gjykata e obligon organin e paditur që në ri-procedurë në afat prej 30 ditësh të veproj sipas vërejtjeve të dhëna në këtë aktgjykim, pra që të trajtoj çështjen në kontekst të Ligjit për 05/l -031 për procedurën e përgjithshme administrative lidhur me afatet, dhe të vlerësoj drejtë provat e administruara si dhe të përcaktoj momentin kohor të parashtrimit të ankesës së paditësit, dhe pasi t'i vlerësoj pretendimet ankimore dhe ti ketë administruar provat dhe faktet në lidhje me to të bie vendim të te drejt dhe mirë të arsyetuar juridikisht.

Duke u bazuar në të dhënat e lart cekura, gjykata në kuptim të nenit 43, 46.2, lidhur me nenet 5, 6 dhe 38 të Ligjit për Konfliktet Administrative, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## **GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**

### **Departamenti për Çështje Administrative**

**A.nr.102/18 dt.25.03.2021**

Gjyqtarja  
*Anita Nikçi-Morina*